



Masat e risocializimit dhe riintegrimin për KDHET-të pas lirit nga burgu në Ballkanin Perëndimor

Autor: **Skender Perteshi**, Ekspert i jashtëm i RNR-së

Radicalisation Awareness Network
RAN 

Masat e risocializimit dhe riintegrimit për KDHEt-të pas lirimit nga burgu në Ballkanin Perëndimor

NJOFTIM LIGJOR

Ky dokument është përgatitur për Komisionin Evropian, por i njëjti pasqyron pikëpamjet vetëm të autorit, dhe Komisioni Evropian nuk mban përgjegjësi për çfarëdo pasoje të mundshme që mund të gjenerohet nga ripërdorimi i këtij botimi. Më shumë informacion mbi Bashkimin Evropian mund të gjeni në faqen e internetit (<http://www.europa.eu>)

Luksemburg: Zyra e publikimeve e Bashkimit Evropian, 2023

© Bashkimi Evropian, 2023



Politika e ripërdorimit të dokumenteve të Komisionit Evropian zbatohet me Vendimin e Komisionit 2011/833/BE të 12 dhjetorit 2011 për ripërdorimin e dokumenteve të Komisionit (Gazeta Zyrtare L 330, 14.12.2011, f. 39). Nëse nuk parashihet ndryshe, ripërdorimi i këtij dokumenti është autorizuar sipas licencës Creative Commons Attribution 4.0 International (CC-BY 4.0) <https://creativecommons.org/licenses/by/4.0/>. Kjo do të thotë se përdorimi ose ripërdorimi lejohet me kusht që të përmendet autori dhe të tregohet çdo ndryshim.

Për çdo përdorim ose riprodhim të elementeve që nuk janë në pronësi të Bashkimit Evropian, leja mund të kërkohet drejtpërdrejt nga titullarët përkatës të të drejtave.

Hyrje

Vendet e Ballkanit Perëndimor kanë një histori komplekse të ndërthurur me ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin. Këto sfida, të shoqëruara me keqkuptimet rreth temës dhe stigmën e lidhur me grupet e lidhura, kanë intensifikuar përpjekjet drejt shkëputjes, risocializimit dhe riintegritimit (SHRR). Për të adresuar çështjet e paraqitura nga kundërvajtësit e dhunshëm ekstremistë dhe terroristë (KDHE) dhe të kthyerit, Ballkani Perëndimor ka zbatuar masa legislative dhe strategji që u caktojnë përgjegjësi të qarta institucioneve dhe agjencive shtetërore në fushën e SHRR-së.

Janë krijuar disa mekanizma institucionalë për të adresuar nevojat për SHRR të KDHE-ve dhe të kthyerve. Shembuj të rëndësishëm përfshijnë Divizionin e SHRR-së në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) të Kosovës¹, Qendra CVE në Shqipëri, Grupi Punues Ndërmintor për Riintegritimin e Luftëtarëve të Huaj Terroristë në Maqedoninë e Veriut, koordinatoret kombëtarë për LT në Serbi dhe Malin e Zi, dhe iniciativat lokale për SHRR në Bosnje dhe Hercegovinë.

SHRR-ja ishte një koncept i ri për vendet e Ballkanit Perëndimor, fillimisht i karakterizuar nga mungesa e ekspertizës dhe përvojës në zbatimin e aktiviteteve të SHRR-së për KDHE-të dhe të kthyerit. Njëpërmjet mbështetjes nga donatorët dhe partnerët ndërkombëtarë, janë ndërmarrë procese të shumta të SHRR-së për të rritur kapacitetet shtetërore në nivel qendror dhe lokal. Progres i dukshëm është arritur në këtë fushë, veçanërisht me përfshirjen aktive të Ballkanit Perëndimor, SHBA-së dhe partnerëve të tjerë në riatdhesimin e qytetarëve të tyre nga zonat e konfliktit. Përafërsisht 500 individë nga Ballkani Perëndimor janë riatdhesuar nga Siria dhe Iraku, ku shumica e tyre marrin pjesë në programet dhe aktivitetet e SHRR-së.

Ky punim shjellon konceptin e ekstremizmit të dhunshëm brenda Ballkanit Perëndimor, duke ofruar njohuri mbi sfondin historik. Ai gjithashtu ofron një përmbledhje të praktikave të deradikalizimit, shkëputjes dhe risocializimit, duke i theksuar sfidat dhe boshllëqet e hasura gjatë fazës pas lirit nga burgu. Për më tepër, punimi i thekson praktikat specifike të SHRR-së.

Zbatimi i programeve të SHRR-së në Ballkanin Perëndimor vjen me sfidat e veta. Ato përfshijnë çështje të tilla si bashkëpunimi ndërinstitucional, paragjykimet dhe diskriminimi ndaj KDHE-ve dhe të kthyerve. Bashkëpunimi efektiv ndërmjet niveleve lokale dhe qendrore mbetet i vështirë për t'u realizuar për shkak të kapaciteteve të kufizuara të institucioneve komunale lokale për t'u angazhuar me KDHE-të dhe të kthyerit. Organizatat e shoqërisë civile kanë luajtur një rol kyç në projektet e SHRR-së, duke kontribuar në mënyrë aktive në nismat që i synojnë këta individë. Iniciativat e spikatura të donatorëve, si ato nga Bashkimi Evropian, Këshilli i Evropës, Rrjeti i Ndërgjegjësimit për Radikalizimin (RAN) dhe Fondi Global për Përfshirjen dhe Rezistencën e Komunitetit (GCERF), janë në ballë të mbështetjes dhe/ose ekzekutimit të projekteve të ndryshme të SHRR-së. Ata punojnë drejtpërdrejt me komunitetet e cenueshme dhe të kthyerit, duke organizuar programe të SHRR-së dhe programe për trajnim profesional. Veçanërisht, KDHE-të dhe të kthyerit kanë përfituar edhe nga skemat e granteve të ofruara nga donatorët në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet shtetërore të Ballkanit Perëndimor.

¹ Ky emërtim është pa paragjykim për pikëpamjet e statusit dhe është në përputhje me UNHCR 1244/1999 dhe mendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për pavarësinë e Kosovës.

Për më tepër, ky punim i shqyrton valët e riatdhesimit nga zonat e konfliktit dhe i eksploron format e shfaqura të ekstremizmit të dhunshëm në rajon. Ai përfundon duke propozuar hapa praktikë për të rritur përpjekjet për SHRR dhe ofron rekomandime për institucionet kyçe për të adresuar në mënyrë efektive sfidat që dalin nga ekstremizmi i dhunshëm.

Metodologjia

Metodologjia e përdorur në këtë punim përbëhet nga intervista gjysmë të strukturuar të kryera me palët e interesuara, hulumtime në zyrë dhe analiza dokumentesh (duke përfshirë, por pa u kufizuar në raportet zyrtare të institucioneve përkatëse). Palët e interesuara të intervistuar ishin, kryesisht nga Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria, duke përfshirë përfaqësues nga Bashkësia Islame e Kosovës, Shërbimi Sprovues i Kosovës (SHPK), Shërbimi Korrektues i Kosovës (SHKK), si dhe ekspertë të OJQ-ve nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova dhe Maqedoninë e Veriut. Analiza e dokumenteve është bërë duke u mbështetur në raportet zyrtare nga institucionet shtetërore në Ballkanin Perëndimor, raportet nga organizatat joqeveritare vendore dhe ndërkombëtare, dhe artikujt e mediave që kanë të bëjnë me luftën kundër dhe parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, dhe deradikalizimin, shkëputjen dhe risocializimin e kundërvajtësve të dhunshëm ekstremistë dhe terroristë.

Punimi është i strukturuar rreth disa pikave kryesore që lidhen me SHRR-në në Ballkanin Perëndimor, duke filluar me hyrjen dhe sfondin e ekstremizmit të dhunshëm, duke përfshirë valët e riatdhesimit nga zonat e konfliktit. Praktikrat dhe sfidat e SHRR-së, si dhe mangësitë në periudhën pas lëshimit nga burgu trajtohen së bashku me hapat praktikë që duhen ndërmarrë në lidhje me SHRR-në. Dokumenti përfundon me rekomandimet kryesore për institucionet kryesore.

Duke i eksploruar këto pika, punimi synon të hedhë dritë mbi gjendjen aktuale të praktikave të SHRR-së në rajon dhe të ofrojë njohuri për përmirësimin dhe forcimin e nismave për të luftuar ekstremizmin e dhunshëm dhe për të promovuar rehabilitimin dhe riintegrimin e suksesshëm të KDHE-ve.

Ekstremizmi i dhunshëm në Ballkanin Perëndimor

Gjatë 12 viteve të fundit, terrorizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm² përbënin kërcënimin më të madh të sigurisë për Ballkanin Perëndimor. Për dekada, Ballkani Perëndimor ka dëshmuar të jetë një terren pjellor për përhapjen e formave të ndryshme të ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit. Historia e konflikteve etnike, fetare dhe civile ka krijuar një cënueshmëri ndaj rekrutimit të terroristëve dhe përhapjes së rrjeteve të dhunshme ekstremiste në rajon. Trazirat e shkaktuara nga shpërbërja e Jugosllavisë, luftërat e mëvonshme etno-nacionaliste dhe konfliktet politike në vendet e Ballkanit Perëndimor kanë ndihmuar më tej ankesat themelore dhe kanë krijuar ndarje të reja etnike. Këto ndarje dhe mungesa e bashkëpunimit midis

² "Udhëzimet për Shërbimet e Burgjeve dhe të Sprovës në Lidhje me Radikalizimin dhe Ekstremizmin e Dhunshëm" e Këshillit të Evropës e përkufizojnë ekstremizmin e dhunshëm si sjellje që promovon, mbështet ose kryen akte që mund të çojnë në terrorizëm dhe që synojnë mbrojtjen e një ideologjie që avokon për supremaci racore, kombëtare, etnike ose fetare.

shteteve dhe shoqërive në të gjithë Ballkanin është një shtytës që kontribuon në praninë dhe tendencat në rritje të formave të ndryshme të ekstremizmit në rajon.³

Ndërsa në vitet e fundit vëmendja është përqendruar në parandalimin dhe kundërvënien e ekstremizmit islamik në rajon, forma të tjera të ekstremizmit u shfaqën në rajon, duke përfshirë lëvizjet etno-nacionale, të djathtën ekstreme dhe lëvizjen ekstremiste të ish-veteranëve të luftës nga luftërat e ish-Jugosllavisë.⁴ Evolucioni i grupeve të ndryshme ekstremiste në Ballkanin Perëndimor mund të nxisë "ekstremizëm kumulativ" ose "radikalizim reciprok", në të cilat këto lëvizje radikale e ushqejnë njëra-tjetrën duke e bërë ndikimin e tyre të mundshëm destabilizues edhe më të madh.⁵ Ky nocion i ekstremizmit kumulativ dhe reciprok është i pranishëm në shumë komunitete në Ballkanin Perëndimor. Prania e saj vihet re në pjesën veriore të Kosovës (në komunat e Mitrovicës së Veriut, Leposaviqit, Zveçanit dhe Zubin Potokut), në Bosnjë dhe Hercegovinë (komuniteti boshnjak dhe serbët në Republika Srpska), dhe në Maqedoninë e Veriut (grupet radikale islamike shqiptare⁶) dhe te grupet e dhunshme ortodokse maqedonase dhe të ekstremit të djathtë.

Krahasuar me format e tjera të ekstremizmit të dhunshëm, fenomeni i terrorizmit të frymëzuar nga islamistët dhe ekstremizmi i dhunshëm është ende i pranishëm në Kosovë, Maqedoninë e Veriut, Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Shqipëri, të cilat janë më të prekura nga numri i qytetarëve që i janë bashkuar organizatave terroriste në Siri dhe Irak, dhe nga niveli i mbështetjes ndaj këtyre organizatave terroriste brenda komunitetit të tyre.⁷ Për më tepër, Serbia sfidohet nga shfaqja e ekstremizmit të djathtë dhe lëvizjes ekstremiste etno-nacionaliste, që reflektohet nga numri i individëve që i janë bashkuar forcave paraushtarake ruse që nga viti 2014, të cilët po luftojnë në Ukrainë. Lëvizjet ekstremiste të ekstremit të djathtë nga Serbia dhe gjetkë po organizojnë dhe marrin pjesë gjithashtu në protesta të dhunshme në zona si Kosova, Mali i Zi dhe Bosnja e Hercegovina. Edhe pse ekstremizmi i dhunshëm i krahut të djathtë është në rritje në të gjithë rajonin, ai është dominant në Serbi dhe Mal të Zi. Të dy vendet në dhjetë vitet e fundit kanë pasur raste kur qytetarët e tyre iu bashkuan organizatave të dhunshme ekstremiste si Daeshi në Siri dhe Irak, dhe të tjerë që u janë bashkuar grupeve paraushtarake ruse të ekstremit të djathtë dhe organizatave të armatosura si WAGNER-i në Ukrainë. Ambasada e Ukrainës në Serbi vlerësoi në vitin 2019 se rreth 300 qytetarë nga Serbia po luftonin përkrah grupeve paraushtarake pro-ruse në Ukrainë, në rajonin lindor të Donbasit.⁸ Që nga fillimi i konfliktit sirian në vitin 2012, bazuar në të dhëna të hapura dhe vlerësime zyrtare nga Ballkani Perëndimor, rreth 1075 individë (878 burra dhe gra dhe 197 fëmijë dhe të moshuar) kanë udhëtuar në Siri dhe Irak. Dy tabelat e mëposhtme listojnë numrin e qytetarëve nga vendet e Ballkanit Perëndimor që kanë udhëtuar në Siri dhe Irak. Këto shifra përfshijnë vetëm burrat dhe gratë që iu bashkuan organizatave terroriste në zonat e luftës, dhe jo të gjithë KDHE-të që janë dënuar për vepra terrorizmi, për shkak të mungesës së të dhënave zyrtare.

³ Raporti Rajonal i Hazinoviçit "Kuptimi i ekstremizmit të dhunshëm në Ballkanin Perëndimor", Këshilli Britanik. Qershor 2018

⁴ Po aty.

⁵ Ramadan Ilazi, Ardit Orana, Teuta Avdimetaj, Bledar Feta, Ana Krstinovska, Yorgos Christidis dhe Ioannis Armakolas 2022. Online and offline (de)radicalisation in the Balkans [(De)radikalizimi online dhe offline në Ballkan] Working paper 5. Publikimet e Projektit PAVE

⁶ Po aty.

⁷ Raporti Rajonal i Vllado Hazinoviçit "Kuptimi i ekstremizmit të dhunshëm në Ballkanin Perëndimor", Këshilli Britanik. Qershor 2018

⁸ Agjencia e lajmeve DW "Vullnetarët serbë dhe kroatë po luftojnë në Ukrainë" 1-31-2023,

Figura 1: Qytetarët e Ballkaniot Perëndimor që i janë bashkuar konflikteve në Siri dhe Irak⁹

Shteti	Burra	Gra	Gjithsej
Shqipëri	96	13	109
Bosnje dhe Hercegovinë	177	63	240
Kosovë	255	48	303
Maqedoni e Veriut	140	14	154
Mali i Zi	18	5	23
Serbi	37	12	49
Gjithsej	723	155	878

Megjithatë, duhet të theksohet se Kosova besohet të ketë përqindjen më të lartë të raportimit, që potencialisht mund të pasqyrojë numrin e lartë të burrave dhe grave që i janë bashkuar konfliktit në Siri dhe Irak.

Valët dhe vështirësitë e riatdhesimit në Ballkanin Perëndimor

Deri në vitin 2012, konfliktet në Lindjen e Mesme konsideroheshin si ngjarje të largëta, ku nuk kishte asnjë shtetas të Ballkanit Perëndimor të raportuar zyrtarisht se ishte i angazhuar si luftëtar i huaj terrorist¹⁰. Kjo ka ndryshuar në vitin 2013 dhe 2014, kur numri i burrave dhe grave që udhëtonin në Siri dhe Irak ishte në kulmin e tij. Pas vitit 2015, agjencitë për zbatimin e ligjit në Ballkanin Perëndimor kanë kriminalizuar pjesëmarrjen në konflikte të huaja dhe kanë filluar të arrestojnë individë që kanë marrë pjesë, kanë mbështetur ose që kanë financuar organizata terroriste aktive që janë aktive në Siri dhe Irak. Në vitin 2014 dhe 2015, institucionet e zbatimit të ligjit në Kosovë filluan arrestimin masiv të individëve që kanë qenë pjesë e organizatave terroriste në Siri dhe Irak: në korrik të vitit 2014 Policia e Kosovës arrestoi rreth 65 KDHE, duke përfshirë 15 udhëheqës fetarë për pjesëmarrje, financim dhe rekrutim për organizatat terroriste në Siri dhe Irak. Gjatë muajit të njëjtë, autoritetet e Maqedonisë së Veriut, Shqipërisë dhe Bosnjë-Hercegovinës kanë arrestuar dhe ndjekur penalisht dhjetëra persona për pjesëmarrjen e tyre në organizata terroriste.¹¹

Pas humbjes së DEASH-it në Siri dhe Irak dhe humbjes së territorit të kontrolluar nga Shteti Islamik, mijëra burra, gra dhe fëmijë u arrestuan dhe u mbajtën në kampe të monitoruara nga forcat kurde brenda Sirisë dhe Irakut.¹² Humbja fizike e DAESH-it e rriti fokusin mbi nevojën për masa dhe programe të SHRR-së për KDHE-të Ballkani Perëndimor, në bashkëpunim të

⁹ Raport i GCERF-it. Rehabilitimi dhe riintegrimi i luftëtarëve të huaj terroristë të kthyer (LHTK) dhe familjeve të tyre në Ballkanin Perëndimor. 2020 [chrome-extension://efaidnbmnnnibpajpcglclefindmkaj/https://www.gcerf.org/wp-content/uploads/2015/12/GCERF-RNA-Western-Balkans-final.pdf](https://www.gcerf.org/wp-content/uploads/2015/12/GCERF-RNA-Western-Balkans-final.pdf)

¹⁰ Sipas Rezolutës 2178 (2014) S/RES/2178 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara "Luftëtar i huaj është një individ që lë vendin e tij të origjinës ose vendbanimit të zakonshëm për t'u bashkuar një grupi të armatosur joshtetëror në një konflikt të armatosur jashtë vendit. dhe i cili është i motivuar kryesisht nga ideologjia, feja dhe/ose lidhja farefisnore".

¹¹ Raporti Rajonal i Vllado Hazinoviçit (2018) "Kuptimi i ekstremizmit të dhunshëm në Ballkanin Perëndimor", Këshilli Britanik.

¹² Perteshi Skender "Beyond the triggers: New threats of Violent Extremism in Kosovo". KCSS, Prishtina 2018 [chrome-extension://efaidnbmnnnibpajpcglclefindmkaj/https://qkss.org/images/uploads/files/violent-extremism-eng_611603.pdf](https://qkss.org/images/uploads/files/violent-extremism-eng_611603.pdf)

ngushtë me SHBA-në, hartoi plane se si të rikthejnë KDHE-të dhe fëmijët nga kampet në Siri dhe Irak në vendet e tyre të origjinës. Në këtë drejtim, në prill të vitit 2019 Kosova ishte ndër të vendet e para që riatdhesoi qytetarët e saj (gjithsej 110 persona) nga Siria dhe Iraku përmes një iniciative të sponsorizuar nga qeveria. Nga të riatdhesuarit, 4 ishin burra, 32 ishin gra dhe 74 ishin fëmijë.¹³ Gratë dhe fëmijët e riatdhesuar fillimisht u strehuan në qendrën e drejtuar nga qeveria për azilkërkuesit për 48 orë. Gjatë qëndrimit të tyre në qendrën e azilkërkuesve, autoritetet intervistuan gratë e kthyer dhe identifikuan nevojat e tyre për integrimin e tyre në komunitet. Katër burra LHK u ndaluan pas mbërritjes, dhe pas procesit të hetimeve, ata u dënuan nga gjykatat.

Operacioni i dytë i riatdhesimit të individëve u krye në korrik të vitit 2021, në një operacion të përbashkët të Kosovës dhe Shqipërisë. Njëmbëdhjetë (11) shtetas u riatdhesuan në Kosovë, ndërsa 5 u riatdhesuan në Shqipëri. Po atë vit, në gusht të vitit 2021, në Shqipëri u riatdhesuan edhe 5 gra dhe 14 fëmijë.¹⁴ Të kthyerit iu nënshtruan kontrolleve të rregullta shëndetësore dhe vlerësimeve, duke përfshirë një përpjekje për të identifikuar nevojat e tyre.²² Pas intervistave dhe vlerësimit të tyre fillestar, institucionet kanë dizajnuar ndërhyrje të rehabilitimit dhe riintegrimin (R&R) për të kthyerit, duke përfshirë, ndër të tjera, mbështetjen mjekësore dhe akomodimin për ata që kanë nevojë.

Në mënyrë të ngjashme, në gusht të vitit 2021, Qeveria e Maqedonisë së Veriut riatdhesoi 23 qytetarë nga zonat e konfliktit. Nga 23 shtetas të riatdhesuar, 5 ishin gra, 4 burra dhe 14 fëmijë¹⁵. Në maj të vitit 2022, 13 shtetas shqiptarë janë riatdhesuar në Shqipëri dhe dy burra janë riatdhesuar në Kosovë.¹⁶ Bosnja dhe Hercegovina, Serbia dhe Mali i Zi gjithashtu kanë riatdhesuar shtetasit e tyre nga Siria dhe Iraku. Në dhjetor të vitit 2019, 24 shtetas boshnjakë u riatdhesuan në BdeH me ndihmën e autoriteteve amerikane. 10 shtetas nga Mali i Zi dhe dymbëdhjetë nga Serbia janë kthyer ose riatdhesuar nga zonat e konfliktit të Sirisë dhe Irakut.¹⁷ Deri më sot, Kosova ka numrin më të lartë të individëve të riatdhesuar nga ish-territori i Daesh-it.

Figura 2: Numri i qytetarëve të riatdhesuar nga zonat e konfliktit në Siri dhe Irak nga Ballkani Perëndimor¹⁸

Shteti	Burra	Gra	Fëmijë	Gjithsej
Shqipëri	30	7	8	45
Bosnje dhe Hercegovinë	56	11	27	94
Mali i Zi	8	1	1	10
Kosovë	124	38	80	242
Maqedoni e Veriut	73	1	2	76

¹³ Teuta Avdimetaj "Stakeholders of (De) Radicalisation in Kosovo" D.RAD 3.1 raport i zhvilluar në kuadër të projektit Horizon 2020 "Deradicalisation in Europe and beyond- Detect, Resolve and Re-Integrate" 2021 chrome-extension://efaidnbmninnipocajpcgclefindmkaj/https://qkss.org/images/uploads/files/Kosovo-D3.2-country-report_208701_.pdf

¹⁴ Perteshi, S. dhe Ilazi, R. (2021). Shpaketimi i përgjigjes së Kosovës ndaj luftëtarëve të kthyer nga zonat e luftës në Syri dhe Irak Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS): https://qkss.org/images/uploads/files/violent-extremism-eng_978757.pdf

¹⁵ Po aty.

¹⁶ AP NEWS "23 shtetas shqiptarë dhe të tjerë nga Kosova janë riatdhesuar nga Siria" 28 maj 2022 <https://apnews.com/article/islamic-state-group-middle-east-syria-albania-iraq-57d8b19ef5cafef5a63e8180d0d1346f>

¹⁷ Raporti Rajonal i Hazinoviçit "Kuptimi i ekstremizmit të dhunshëm në Ballkanin Perëndimor", Këshilli Britanik. Qershor 2018

¹⁸ Po aty.

Serbi	9	1	2	12
Gjithsej	300	59	120	479

Në përgjithësi, pavarësisht nga dallimet në numrin e të kthyerve midis vendeve (shih shembujt më lart), vendet e Ballkanit Perëndimor kanë demonstruar gatishmëri për të riatdhesuar qytetarët e tyre që iu bashkuan Daesh-it në Siri dhe Irak. Institucionet shtetërore përgjegjëse për SHRR-në e KDHE-ve dhe të kthyerve kanë ndarë burime për të rritur kapacitetet e tyre profesionale dhe mekanizma të dedikuar për rehabilitimin dhe riintegrimin e suksesshëm. Kosova, Bosnja dhe Hercegovina, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut, të cilat kanë numrin më të madh të luftëtarëve të huaj terroristë në Ballkanin Perëndimor, kanë zhvilluar programe të ndryshme brenda burgjeve dhe në nivel të komunitetit për të adresuar nevojat e individëve të riatdhesuar. Mali i Zi dhe Serbia kanë zbatuar gjithashtu programe të SHRR-së edhe pse kanë numër të kufizuar të qytetarëve që kanë udhëtuar në zonat e konfliktit në Siri dhe Irak.

SHRR në Ballkanin Perëndimor pas lëshimit nga burgu të KDHE-ve

Reformat institucionale

Procesi i SHRR-së është kompleks dhe kërkon përfshirjen e aktorëve të ndryshëm. Një nga sfidat kryesore në procesin e SHRR-së të kthyerve nga zonat e konfliktit është nevoja për bashkëpunim ndërmjet institucioneve dhe agjencive përgjegjëse për zbatimin e aktiviteteve të SHRR-së. Me kalimin e kohës, në Ballkanin Perëndimor janë realizuar reforma institucionale dhe janë krijuar mekanizma të rinj me qëllim të rritjes së bashkëpunimit ndërmjet aktorëve të ndryshëm të përfshirë në SHRR-në e të kthyerve. Këto përpjekje janë thelbësore për të adresuar në mënyrë efektive nevojat e individëve që kthehen nga zonat e konfliktit dhe për të promovuar riintegrimin e suksesshëm në shoqëri.

Shqipëria ka krijuar Qendrën Kombëtare për Kundërvënien ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm (Qendra CVE), përgjegjëse për koordinimin e aktiviteteve të parandalimit dhe luftimit të ekstremizmit të dhunshëm ("Aktivitetet P/KEDH") në vend dhe për të udhëhequr procesin e SHRR-së të individëve shqiptarë të riatdhesuar nga zonat e konfliktit. Për një koordinim më të mirë midis aktorëve shqiptarë për SHRR, Qeveria e Shqipërisë ka krijuar Qendrën Pritëse e Trajtimit të Rasteve të Rikthyer nga Siria dhe Iraku, e cila kryen vlerësime dhe vlerësime të ndryshme të individëve të riatdhesuar.¹⁹ Maqedonia e Veriut themeloi Komitetin Kombëtar për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftimin e Terrorizmit, të udhëhequr nga koordinatori kombëtar përgjegjës për hartimin, koordinimin dhe zbatimin e politikave dhe aktiviteteve të SHRR në Maqedoninë e Veriut. Për më tepër, qeveria krijoi një Grup Pune Ndërmnistror për Riintegrimin e Luftëtarëve të Huaj Terroristë në vitin 2021. Grupi i punës u mandatua të zhvillojë një plan veprimi të detajuar për institucionet që të ofrojnë trajtim adekuat shëndetësor, arsim, siguri si dhe mbështetje psikosociale, socio-ekonomike dhe ligjore për të

¹⁹ Manuali i trajnimit për udhëheqësit "Hartëzimi i shërbimeve R&R për personat që kthehen nga zonat e konfliktit" IDM 2021.

dënuarit terroristë për të shmangur stigmatizimin.²⁰ Ky mekanizëm gjithashtu ka nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi (MM) me autoritetet lokale për zbatimin e programeve të SHRR me të kthyerit. Megjithatë, pavarësisht përpjekjeve të autoriteteve të Maqedonisë së Veriut për të koordinuar ndërmjet palëve të ndryshme të interesit në SHRR, niveli i bashkëpunimit në praktikë mbetet shumë i ulët,²¹ madje edhe në nivel ministror. Nuk ka module trajnimi për stafin, që u ndihmon praktikuesve të punojnë drejtpërdrejt me këta të kthyer ose me ata që janë të përfshirë në procesin e SHRR-së në komunitet. Nuk ka plane formale SHRR-së për individët e riadhesuar. Për më tepër, nuk ka protokolle të veçanta për punonjësit socialë që punojnë me KDHE-të.²² Në rastin e BdeH, Ministria e Sigurisë në bashkëpunim me ministritë dhe agjencitë e tjera shtetërore ka krijuar mekanizma për R&R, të cilat kanë të bëjnë edhe me qytetarët e riadhesuar nga zonat e konfliktit. Në korrik të vitit 2023, Qeveria e Serbisë ka publikuar vendimin Nr. 58-2023, për krijimin e organit kombëtar për parandalimin dhe luftën kundër terrorizmit, si dhe për emërimin e koordinatorit kombëtar për parandalimin dhe luftimin e terrorizmit. Ky organ e koordinon zbatimin e aktiviteteve të R&R dhe P/KEDH në Serbi. Pavarësisht nga shumë mekanizma të brendshëm të krijuar me synimin për të koordinuar aktivitetet për P/KEDH dhe R&R, bashkëpunimi ndërmjet institucioneve dhe agjencive për zbatimin e ligjit mbetet një sfidë.

Krahasuar me shembujt e tjerë rajonalë, Kosova ka ndërmarrë reforma të shumta institucionale në drejtim të luftimit të terrorizmit, si dhe në fushën e shkëputjes, rehabilitimit dhe riintegritimit. Kosova ka themeluar Divizionin për Parandalimin dhe Riintegritimin e Personave të Radikalizuar (DPRPR), që është përgjegjës për koordinimin e politikave kombëtare për P/KEDH dhe DRR për individët e riadhesuar nga zonat e konfliktit.²³ Për më tepër, Kosova ka kryer shumë reforma institucionale në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës (SHKK) në lidhje me LT dhe SHRR. Me reformat e SHKK-së u rregullua se të gjithë të burgosurit e dënuar për vepra terrorizmi duhet të vendosen në dy objekte të burgjeve. Ata që ishin kategorizuar me kërcënim të ulët dhe të mesëm të sigurisë u dërguan në një pavijon në qendrën e paraburgimit në Dubravë, ndërsa ata që ishin kategorizuar si kërcënim i lartë i sigurisë u dërguan në një pavijon të caktuar në burgun e sigurisë së lartë në Gërdovc të Prishtinës.²⁴ Një nismë tjetër e rëndësishme në SHKK ishte organizimi i ligjërave nga Bashkësia Islame e Kosovës për të burgosurit KDHE, në bazë të marrëveshjes së mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë (MD) dhe Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK). Sipas një zyrtari nga SHKK, gjysma e të burgosurve të dënuar për rastet e terrorizmit të kategorizuara si kërcënim i nivelit të ulët dhe të mesëm të sigurisë ishin pjesë e programit. Ndërsa të tjerët, të kategorizuar si kërcënim i lartë i sigurisë, nuk kanë marrë pjesë në ligjërata.²⁵ Në vitin 2019, SHKK-ja themeloi dy njësi të brendshme të specializuara në menaxhimin e P/KEDH dhe R&R, përkatësisht njësinë për Menaxhimin e Ekstremizmit të Dhunshëm në kuadër të SHKK-së dhe njësinë e Inteligjencës dhe Analizës.²⁶ Të dy mekanizmat janë ende funksionalë dhe janë organ thelbësor i SHKK-së.

²⁰ Projekti "Shkëputja, rehabilitimi dhe riintegrimi i luftëtarëve të huaj terroristë" i financuar nga Fondi i Sigurisë së Brendshme - Policia i Bashkimit Evropian. Mars 2022

²¹ Intervistë me ekspertin e TCT-CVE në Maqedoninë e Veriut, 13 prill 2023.

²² Raporti DRIJVE 2021

²³ Teuta Avdimetaj "Stakeholders of (De) Radicalisation in Kosovo" D.RAD 3.1 raport i zhvilluar në kuadër të projektit Horizon 2020 "Deradicalisation in Europe and beyond- Detect, Resolve and Re-Integrate" 2021

²⁴ Projekti "Shkëputja, rehabilitimi dhe riintegrimi i luftëtarëve të huaj terroristë" i financuar nga Fondi i Sigurisë së Brendshme - Policia i Bashkimit Evropian. Mars 2022

²⁵ Po aty:

²⁶ Po aty:

SHRR dhe praktikat në rajonin e Ballkanit Perëndimor

Ekzistojnë disa nisma të SHRR të drejtuara nga donatorët në Ballkanin Perëndimor që mbështesin përpjekjet e shteteve në procesin e SHRR-së për KDHE-të dhe individët e tjerë të riatdhesuar në periudhën pas lirit nga burgu. Organizata Ndërkombëtare e Migracionit (IOM) është ndër organizatat e para që vendosi projekte rajonale për SHRR në vendet e Ballkanit Perëndimor. Fillimisht, IOM-i kreu një vlerësim bazë për nevojat e të kthyerve nga Siria dhe Iraku. IOM-i në Kosovë, Maqedoninë e Veriut dhe BdeH u shpërndau ushqime dhe veshje të kthyerve dhe KDHE-të, si dhe familjeve të tyre pas kthimit të tyre në komunitet.²⁷ IOM-i mbështeti KDHE-të dhe të kthyerit dhe anëtarët e familjeve të tyre me dhjetëra grante për të filluar bizneset e tyre individuale (si p.sh. në bujqësi, punime të ndërtimit, instalime elektrike, larje të veturave). Në bazë të përfaqësuesve të MPB-së në Kosovë, ndihma e IOM-it ishte thelbësore për të ndihmuar autoritetet e Kosovës në procesin e riintegrit të të kthyerve në komunitet.²⁸

Krahas projekteve të IOM-it, Fondi Global për Përfshirjen dhe Rezistencën e Komunitetit (GCERF) ka mbështetur OJQ-të lokale në rajon për të zbatuar disa projekte me synimin për të mbështetur SHRR-në e KDHE-të.²⁹ Në rastin e Kosovës, organizatat joqeveritare si Fondi për Zhvillimin e Komunitetit (FZHK), me mbështetjen e GCERF, ofruan trajnime për aftësi profesionale, trajnime për lidhshmëri, aktivitete kulturore dhe sportive për individët dhe komunitetet e prekura nga ekstremizmi i dhunshëm. Nëpërmjet këtyre nismave, GCERF-i synon të krijojë një mjedis të sigurt dhe të përshtatshëm për riintegrimin e të kthyerve nga zonat e luftës. Për më tepër, Fondi për Zhvillimin e Komunitetit i mbështet KDHE-të me trajnime për aftësi profesionale për ide të biznesit. Rreth 30 gra të kthyerja janë trajnuar për rrobaqepësi. Këto gra janë mbështetur edhe me blerjen e makinave qepëse për to.³⁰ FZHK-ja është gjithashtu në proces të dhënies së valës së dytë të granteve për KDHE-të. QKSS-ja me mbështetjen e ambasadave të Mbretërisë së Bashkuar dhe Mbretërisë së Holandës në Kosovë ka organizuar trajnim profesional për 20 gra KDHE-të se si të përdorin mediat sociale për të promovuar idetë e tyre të biznesit dhe produktet e tyre. Ky trajnim i ndihmon gratë e kthyerja për t'i sjellë produktet e tyre më afër audiencës së synuar dhe klientëve të mundshëm.

GCERF-i ka mbështetur gjithashtu përpjekjet e OJQ-ve lokale në Bosnje dhe Hercegovinë për SHRR-në e KDHE-të dhe LFT-ve. Përveç mbështetjes së drejtpërdrejtë për KDHE-të, të kthyerit dhe familjet e tyre, OJQ-të lokale boshnjake kanë forcuar kapacitetet e punëtorëve të vijës së parë dhe kanë zhvilluar një mjedis të favorshëm për rehabilitimin dhe riintegrimin.³¹

GCERF gjithashtu ka mbështetur katër OJQ në Maqedoninë e Veriut dhe Shqipëri, si Shoqatën e Juristëve të Rinj, Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim dhe Terre de Hommes Albania. Projektet e mbështetura nga GCERF-i në të dyja vendet nuk u fokusuan në mënyrë specifike tek KDHE-të e liruar nga burgu. Projektet kishin edhe komponentë të tjerë të SHRR-së si p.sh. trajnimi i autoriteteve lokale për SHRR dhe rritja e kapaciteteve shtetërore në përdorimin e mjeteve të vlerësimit të rrezikut për KDHE-të. Këshilli i Evropës gjithashtu zbaton një projekt

²⁷ Intervistë me përfaqësuesin e lartë të Divizionit për Rehabilitim dhe Riintegrim të qytetarëve të riatdhesuar nga Siria dhe Iraku. MPB. 22 Mars 2023, Prishtinë, Kosovë.

²⁸ Intervistë me përfaqësuesin e lartë të Divizionit për Rehabilitim dhe Riintegrim të qytetarëve të riatdhesuar nga Siria dhe Iraku. MPB. 22 Mars 2023, Prishtinë, Kosovë.

²⁹ Perteshi Skender dhe Orana Ardit "Shkëputja, rehabilitimi dhe riintegrimi i luftëtarëve të huaj terroristë"

³⁰ Perteshi Skender dhe Orana Ardit "Shkëputja, rehabilitimi dhe riintegrimi i luftëtarëve të huaj terroristë"

³¹ Raport i GCERF-it "Rehabilitimi dhe riintegrimi i luftëtarëve të huaj terroristë të kthyer (LHTK) dhe familjeve të tyre në Ballkanin Perëndimor", Prill 2020.

rajonat për SHRR që synon rritjen e kapaciteteve të autoriteteve korrektuese dhe sprovuese të Ballkanit Perëndimor në trajtimin e KDHE-ve dhe procesit SHRR.³²

Ka edhe iniciativa të tjera që kanë kontribuar në procesin e R&R në Ballkanin Perëndimor. Për shembull, Bashkësia Islame e Maqedonisë krijoi një organ specifik për R&R të të kthyerve dhe parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm në Maqedoninë e Veriut. Ky organ ka bërë një punë të rëndësishme në ndihmën e autoriteteve shtetërore në procesin e SHRR-së duke plotësuar një boshllëk të rëndësishëm dhe duke vepruar si ndërmjetës i besueshëm ndërmjet KDHE-ve dhe institucioneve shtetërore në Maqedoninë e Veriut.³³ Shoqatat Islame në BeH dhe në Kosovë gjithashtu kanë luajtur një rol të rëndësishëm në procesin e R&R të të kthyerve. Forumet e grave të Shoqatave Islame në të dy vendet kanë ndihmuar KDHE-të me pako ushqimore, akomodim dhe edukim fetar në koordinim të ngushtë me Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB).³⁴

Kur trajtohen programet e SHRR-së dhe zbatimi i tyre, mund të vërehen dallime ndërmjet burrave dhe grave të kthyer/a. Krahasuar me burrat, gratë e kthyerat ishin më të gatshme për të marrë pjesë në programet e SHRR të zbatuara nga organizatat lokale dhe ndërkombëtare. Gratë e riadhesuara u certifikuan nga kompanitë profesionale dhe po punojnë për të përshtatur njohuritë e tyre me nevojat e tregut me qëllim rritjen e të ardhurave të tyre familjare. Pajisjet dhe grantet u janë dhënë grave që kanë marrë pjesë në trajnim.³⁵

Ndjekja penale e KDHE-ve

Provat për ndjekjen penale të KDHE-ve kanë rezultuar të vështira për t'u gjetur për agjencitë e zbatimit të ligjit dhe autoritetet e tjera të sigurisë. Çdo vend u përball me sfida të rëndësishme në trajtimin e luftëtarëve të huaj dhe familjeve të tyre që janë kthyer ose janë riadhesuar nga zonat e konfliktit. Prokurorët u përballën gjithashtu me vështirësi për të proceduar rastet para gjykatave, dhe gjyqtarët gjithashtu u përballën me vështirësi për të vendosur për shkallën e dënimit për shkak të informacionit dhe provave të kufizuara për pjesëmarrjen e KDHE-ve në zonat e konfliktit në Siri dhe Irak.³⁶

Në procesin e dënimit të KDHE-ve nga autoritetet gjyqësore në Ballkanin Perëndimor janë përdorur praktika të ndryshme dhe jo të gjitha janë në përputhje me praktikën e dënimeve të vendeve të BE-së. Ka dallime në dënimet mesatare me burg në Ballkanin Perëndimor në krahasim me ato të vendeve të BE-së. Mesatarja e dënimit për vepra terrorizmi në vendet e BE-së është shtatë vjet burg, ndërsa në Ballkanin Perëndimor është nga 2,5 deri në 3 vjet burg.³⁷ Kosova ka numrin më të lartë të KDHE-ve të dënuar për vepra terrorizmi me 125 raste, e ndjekur nga BdeH me 45 raste, Maqedonia e Veriut me 29 dhe Serbia me 23 raste. Shqipëria ka dënuar 12 imamë që kanë rekrutuar anëtarë për organizata terroriste. Shqipëria nuk ka dënuar shtetasit e saj që janë kthyer nga konfliktet e Sirisë dhe Irakut, që është një rast unik në krahasim me shembujt e tjerë rajonalë, për shkak të mungesës së provave për të mbështetur rastet në gjykatë dhe për shkak të mungesës së përvojës së sektorit të drejtësisë shqiptare për të hetuar rastet e terrorizmit. Qeveria shqiptare vendosi një qasje më të butë ndaj LHT-ve të kthyer nga zonat e luftës. Mali i Zi ka gjithashtu dy raste të dënuara për vepra

³² Të dhëna të mbledhura nga ueb-faqja zyrtare e GCERF-it. Aksesuar në prill të vitit 2023.

³³ Të dhëna të mbledhura nga ueb-faqja zyrtare e GCERF-it. Aksesuar në maj të vitit 2023.

³⁴ Intervistë me një imam të lartë nga Bashkësia Islame e Kosovës. 14 mars 2023, Prishtinë.

³⁵ Intervistë me zyrtarin e lartë të Divizionit për Rehabilitim dhe Riintegrim të qytetarëve të radikalizuar. 22 mars 2023.

³⁶ Raporti i OSBE-së 2022

³⁷ Po aty

terrorizmi. Në rastin e Serbisë, ka dallime midis dënimeve për luftime në Siri dhe në Ukrainë. Luftëtarët e kthyer nga Ukraina kanë marrë dënime me kusht ose paraburgim shtëpiak, ndërsa dënimet për ata që janë kthyer nga Siria varionin nga 3 deri në 11 vjet burg.³⁸ Pavarësisht informacionit të kufizuar të zotëruar nga prokuroria dhe gjykatat, sektori gjyqësor në Ballkanin Perëndimor ka arritur të dënojë rreth 234 individë për vepra terrorizmi dhe pjesëmarrje në konflikte të huaja si pjesë e organizatave terroriste.³⁹

Figura 3: Numri i rasteve dhe dënimeve të dhëna për KDHE-të dhe të kthyerit⁴⁰

Shteti	Dënimet	Të kthyerit nga Siria	Të kthyerit nga Ukraina	Terrorizmi vendor	Dënimi me burg	Dënim me kusht ose paraburgim shtëpiak
Kosovë	155	155	0	0	123	32
Bosnjë dhe Hercegovina	45	44	1	0	45	0
Shqipëri	15	Të pa hetuara-dënuara	0	15	15	0
Mali i Zi	2	1	1	0	2	0
Serbi	23	7	16	0	7	16
Maqedoni e Veriut	29	29	0	0	29	0

Deri më sot, gjykatat serbe kanë dënuar 16 individë për përfshirjen e tyre në konfliktin në Ukrainë.⁴¹ Të gjithë u dënuan me dënim me kusht deri në një vit.⁴² Mali i Zi ka dënuar një individ për luftimin përkrah forcave pro-ruse në Ukrainë.⁴³

Një fokus më specifik iu kushtua zhvillimit të programeve të SHRR-së për gratë e riatdhesuara që u ndoqën penalisht për pjesëmarrjen e tyre në zonat e konfliktit. Gjatë procesit të vlerësimit të grave të kthyer nga zonat e konfliktit, autoritetet shtetërore nuk zotëronin aftësi profesionale për të identifikuar nevojat e tyre për SHRR-së. Për më tepër, autoritetet nuk përdorën asnjë mjet vlerësimi të rrezikut të njohur ndërkombëtarisht për të matur nivelin e tyre të stresit, stigmës, PTSD-në, sulmet e panikut, gjendjet e shëndetit mendor dhe sfida të tjera të ngjashme. Gjykatat në Maqedoninë e Veriut, Kosovë, BdeH dhe Shqipëri ishin më të buta në dhënien e dënimeve për gratë pjesëmarrëse në zonat e konfliktit në krahasim me burrat. Për gratë e kthyer që kanë marrë pjesë në konflikte të huaja si pjesë e ISIS-it, autoritetet gjyqësore të Maqedonisë së Veriut, BdeH-së dhe Kosovës kanë dhënë dënime me kusht ose paraburgim shtëpiak, ndërsa burrat luftëtarë të huaj janë dënuar me burg. Autoritetet gjyqësore të Ballkanit Perëndimor argumentojnë se grave u janë dhënë dënime të buta sepse

³⁸Po aty

³⁹ Asya Metodjeva "Bringing them back"

⁴⁰ Po aty.

⁴¹ Po aty

⁴² Radio Evropa e Lirë "Anulohet dënimi me burg për serbin që iu bashkua forcave të mbështetura nga Rusia në Ukrainë" 27 janar 2023.

⁴³ Balkan Insight analizon "Malit të Zi i kërkohet të parandalojë luftëtarët vullnetarë që shkojnë në Ukrainë" 1 mars 2022.

ishite e vështirë të argumentohej roli i grave në konflikt, ose nëse gratë kanë marrë pjesë në luftime. Sipas gjyqtarëve, një arsye tjetër është se gratë nuk paraqesin kërcënim për komunitetin.⁴⁴ Gjyqtarët nuk kanë vendosur rregulla të qarta se në bazë të cilëve tregues apo informacione vendosën të japin vetëm dënim me kusht për gratë e riatdhesuara, ose për të arritur në përfundimin se gratë e riatdhesuara paraqesin kërcënim më të vogël për komunitetin sesa burrat e riatdhesuar nga zonat e konfliktit.⁴⁵ Ky vendim u mor sepse në shumicën e rasteve gratë ishin prindër të vetëm që duhej të kujdeseshin për fëmijët e tyre sepse burrat e tyre u vranë në zonat e konfliktit.⁴⁶ Për më tepër, në rastin e Kosovës, gjykatësi shprehu pikëpamjen e tij se shumica e grave të kthyer ose të riatdhesuara janë dënuar për pjesëmarrje në mbështetje logjistike në ISIS-it, e jo për pjesëmarrje të drejtpërdrejtë në aktivitete luftarake. Si rezultat, perceptimi i gjykatës ishte se gratë e kthyer nuk paraqisnin ndonjë rrezik të rëndësishëm për shoqërinë.⁴⁷

Një qasje e ngjashme u zbatua edhe në raste të tjera në rajon në lidhje me ndjekjen penale të grave të përfshira në vepra terrorizmi. Krahasuar me vendet e BE-së si Franca, Belgjika ose Holanda, ku gratë përballëshin me sistemin e drejtësisë penale si luftëtarët meshkuj terroristë, dhe fëmijët caktohen në familjen e origjinës ose në familje kujdestare, konteksti në Ballkanin Perëndimor është i ndryshëm. Vendet e BE-së kanë mekanizma të vendosura mirë dhe kapacitete për të trajtuar familjet dhe fëmijët. Vendeve të Ballkanit Perëndimor u mungojnë mekanizmat shtetërorë për t'u kujdesur për fëmijët jetimë ose për fëmijët e braktisur që kanë nevojë për kujdes. Në vendet e Ballkanit Perëndimor, mekanizmat për ofrimin e kujdesit për fëmijët në nevojë kanë kapacitete dhe burime dhe mund të funksionojnë vetëm me një numër të vogël fëmijësh me të cilët arrijnë të punojnë. Në mënyrë indirekte kjo është një tjetër arsye pse gjykatat në vendet e Ballkanit Perëndimor kanë dhënë dënime me kusht deri në tre vjet për gratë LHTK.⁴⁸

Zbrazëtirat dhe sfidat e SHRR dhe të KDHET-ve në Ballkanin Perëndimor

Procesi i SHRR-së ishte një përvojë e re për vendet e Ballkanit Perëndimor. Pavarësisht vullnetit të përgjithshëm institucional për hartimin dhe zbatimin e këtyre programeve, për shkak të kapaciteteve të kufizuara profesionale dhe përvojës në fillim, progresi në SHRR kishte vend për përmirësim. Gjatë procesit të përgatitjes dhe zbatimit të praktikave dhe programeve të SHRR-së, natyrisht u shfaqën sfida të ndryshme, ndër të cilat diskriminimi dhe stigma ndaj KDHET-ve në periudhën e pas lirit nga burgu, mungesa e përfshirjes së bashkive/komunave dhe komunitetit, mungesa e bashkëpunimit institucional, boshllëqet në ndarjen e të dhënave ndërmjet agjencive, mungesa e kapaciteteve institucionale për të ofruar trajnime profesionale. Secila prej këtyre sfidave do të trajtohet dhe shqyrtohet më poshtë.

⁴⁴ Raporti i OSBE-së 2022.

⁴⁵ Po aty.

⁴⁶ Intervistë me zyrtar të lartë të MPB-së në Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut. Maj 2023.

⁴⁷ Raporti i OSBE-së 2022

⁴⁸ Intervistë me zyrtar të lartë të MPB-së në Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut. Maj 2023.

Diskriminimi dhe Stigma ndaj KDHET-ve në periudhën pas lirim nga burgu

KDHETtë e liruar nga burgu dhe individët e tjerë të riatdhesuar kanë frikë nga stigma dhe diskriminimi nga sektori privat apo komuniteti. Dhe ata kanë të drejtë që kanë frikë, sepse qytetarët hezitojnë të pranojnë KDHET-të dhe individët e riatdhesuar në komunitetin e tyre. Një sondazh mbi perceptimin e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm në BdeH tregon se 60% e të anketuarve kanë opinion negativ ndaj KDHET-ve dhe të kthyerve për sa i përket integritit të tyre në komunitet.⁴⁹ Qytetarët e Kosovës gjithashtu ndajnë një perceptim negativ ndaj KDHET-ve të pas lirim nga burgu dhe të kthyerve nga Siria dhe Iraku. Bazuar në të dhënat e Barometrit Kosovar të Sigurisë për vitin 2022, 58 për qind e të anketuarve i perceptojnë ish-KDHET-të dhe të kthyerit si kërcënim, ndërsa 21 për qind mendojnë se ata nuk paraqesin fare kërcënim.⁵⁰ Kur bëhet fjalë për pranimin e KDHET-ve pas lirim nga burgu, komunitetet lokale tregojnë rezistencë dhe refuzim. Më shumë se 50 për qind e të anketuarve kosovarë thanë se nuk do të pranonin KDHET-të ose të kthyerit në komunitetin e tyre, ose nuk do të ndjeheshin të sigurt për të jetuar në të njëjtin vend me të kthyerit nga zonat e konfliktit.⁵¹ Për shkak të stigmës dhe diskriminimit, individët e riatdhesuar refuzojnë të aplikojnë për punë në sektorin privat dhe po kërkojnë mundësi për të emigruar në vendet e BE-së për qëllime pune, ose kërkojnë mundësi për të hapur bizneset e tyre private.

Mungesa e bashkëpunimit institucional dhe e aftësive të specializuara në nivel lokal në periudhën pas lirim nga burgu

Për shumë vite, SHRR-ja ka mbetur mandat i institucioneve qendrore në rajon. Pra, nuk është befasi që bashkëpunimi ndërmjet nivelit lokal dhe autoriteteve qendrore të përfshira në P/KEDH dhe SHRR mbetet një sfidë. Ka disa pengesa të cilat e pengojnë bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve të pushtetit qendror dhe bashkive/komunave si: mungesa e kapaciteteve profesionale të autoriteteve lokale për t'u marrë me KDHET-të dhe individët e riatdhesuar, si dhe mungesa e njohurive të autoriteteve lokale për SHRR dhe P/KEDH. Në rastin e rajonit të Ballkanit Perëndimor, fokusi i donatorëve ndërkombëtarë dhe qeverive vendore të vendeve të Ballkanit Perëndimor ishte ngritja e kapaciteteve të institucioneve në nivel qendror për çështjet e parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm dhe procesin e SHRR-së. Projektet shumë të kufizuara u fokusuan në ngritjen e kapaciteteve të organeve komunale lokale për P/KEDH dhe SHRR. Përkundër gatishmërisë së autoriteteve lokale për të ndihmuar dhe mbështetur procesin e SHRR-së të KDHET-ve në periudhën pas lëshimit nga burgu, komunat nuk kanë kapacitete financiare, përvojë dhe njohuri se si të kontribuojnë për SHRR-në e KDHET-ve.⁵² Është arritur njëfarë progresi në procesin e ngritjes së kapaciteteve komunale për SHRR dhe P/KEDH. Janë organizuar një sërë trajnimesh me komunat lokale dhe OSHC-të, por ende duhet të punohet në mënyrë që të përfshihet niveli komunal në periudhën pas lirim nga burgu të të kthyerve.

⁴⁹ Korajlić Nedžad, Kržalić Armin, Kržalić Aida, Plevljak Benjamin, Dulaš Imer (2020). *TRAVELLERS TO SYRIA: A Criminological and Security Analysis with Special Focus on Returnees from Syrian Battlefronts*.

⁵⁰ Raporti i Barometrit të Sigurisë së Kosovës 2022.

⁵¹ Po aty.

⁵² Intervistë me zyrtarë të lartë të MPB-së në Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut. Maj 2023

Mungesa e ndarjes së të dhënave ndërmjet agjencive

Shkëmbimi i të dhënave në periudhën para lirimit të të burgosurve është i një rëndësie të madhe, duke qenë se i ndihmon autoritetet të përgatisin plane më të mira individuale të SHRR-së, të rrisin koordinimin ndërmjet agjencive dhe të ndihmojnë agjencitë në përgatitjen e shërbimeve mbështetëse të përshtatura për nevojat e KDHE-ve pas lirimit. Ai gjithashtu lehtëson vendimmarrjen e bazuar në informacion, e rrit sigurinë publike dhe e mbështet riintegrimin e suksesshëm të individëve në shoqëri.

Megjithatë, kjo mbetet një nga sfidat më të mëdha. Mungesa e shkëmbimit të të dhënave ndërmjet institucioneve në Ballkanin Perëndimor po i pengon institucionet si p.sh. autoritetet lokale dhe shërbimet e provës që të përgatisin programe dhe ndërhyrje të SHRR-së për individët që lirohen nga burgjet. Për shembull, në rastin e Kosovës gjatë lirimit me kusht të LHT-ve nga burgjet, autoritetet sprovuese duhet të informohen së paku tre muaj përpara. Në praktikë, kjo procedurë nuk ndiqet nga Shërbimi Korrektues i Kosovës dhe Ministria e Punëve të Brendshme në lidhje me lirin me kusht dhe dënimet me kusht, gjë që i kufizon mundësitë e shërbimit sprovues për të përgatitur plane dhe aktivitete riintegruese.

Një nga arsyt pse ndarja e të dhënave ndërmjet agjencive mbetet sfidë është mungesa e rregullimit legjislativ. Vendet e Ballkanit Perëndimor nuk kanë arritur të përgatisin një kornizë normative që do t'i rregullojë rregullat dhe procedurat e shkëmbimit të të dhënave për individët e dënuar për vepra të lidhura me terrorizmin.

Mungesa e kapaciteteve dhe fokusimi në trajnimet profesionale në periudhën e pas lirimit nga burgju

Në rastin e Ballkanit Perëndimor, potenciali për ofrimin e ndërhyrjeve të SHRR-së dhe trajnimit profesional për të burgosurit e dënuar për vepra terrorizmi po përballlet me dy sfida kryesore: kapacitetet e kufizuara të agjencive shtetërore për të ofruar trajnim profesional gjatë periudhës para dhe pas lirimit nga burgju, dhe mungesa e vullnetit të të burgosurve për të marrë pjesë në trajnimet profesionale. Ky është një problem pasi, për shembull, në rastin e Kosovës, të dhënat tregojnë se shumica e të burgosurve KDHE, të cilët ishin kategorizuar si kërcënim i lartë ose i mesëm për sigurinë, nuk kanë marrë pjesë në trajnime për arsye ideologjike apo për shkak të stigmës.⁵³

Pengesat, si p.sh. sistemi i fragmentuar dhe burimet e kufizuara financiare, e kufizojnë fushëveprimin e këtyre agjencive dhe potencialin për të ofruar shërbim cilësor për të burgosurit dhe KDHE-të në periudhën pas lirimit nga burgju. Autoritetet sprovuese dhe korrektuese në rajon nuk kanë arritur të ndërtojnë një koordinim efektiv me punëdhënësit e mundshëm në sektorin privat, gjë që është thelbësore për të siguruar që programet e formimit profesional të përputhen me kërkesat e tregut të punës dhe të çojnë në mundësi domethënëse punësimi për të burgosurit e liruar. Për shkak të njohurive dhe burimeve të kufizuara financiare, programet e R&R pas lirimit nga burgju organizohen kryesisht nga donatorët përmes OSHC-ve lokale.

Korniza e Mjeteve të vlerësimit të rrezikut

Unifikimi i mjeteve të vlerësimit të rrezikut ose i kornizave të vlerësimit të cenueshmërisë mbetet një sfidë e rëndësishme në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Ndërsa agjencitë e sigurisë, duke përfshirë policinë dhe inteligjencën, kanë përdorur mjete të ndryshme të njohura ndërkombëtarisht për vlerësimin e rrezikut, institucione të tjera si autoritetet korrektuese ose të provës, nuk kanë zbatuar modele të vlerësimit të rrezikut për të vlerësuar qytetarët e riatdhesuar nga zonat e konfliktit. Institucionet e sigurisë dhe të drejtësisë në Ballkanin Perëndimor nuk kanë krijuar ende një strukturë dhe sistem të unifikuar për kornizat e vlerësimit të rrezikut për individët që janë radikalizuar dhe dënuar për terrorizëm. Qeveria e Kosovës është në fazat e hershme të zbatimit të programit kornizë të vlerësimit të cenueshmërisë (VAF) të quajtur "Channel" ("Kanali"). Ky është një program për vlerësimin e rrezikut të cenueshmërisë që ndihmon autoritetet shtetërore të masin nivelin e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm të individëve. Ky program ndihmon autoritetet që të përgatisin ndërhyrje për individët që kalojnë nëpër programin "Kanali". MPB-ja e Kosovës dhe Policia e Kosovës po e përdorin rregullisht këtë mjet në punën e tyre me KDHE-të dhe të kthyerit apo të tjerët që janë të radikalizuar. Programi për vlerësimin e rrezikut të cenueshmërisë "Kanali" ka filluar të përdoret edhe në nivel lokal, në komunën e Hanit të Elezit dhe Mitrovicës. Në të dyja komunat janë formuar dy ekipe multidisiplinare. Anëtarë të këtyre ekipeve multidisiplinare janë psikologë, mjekë, profesorë, punonjës socialë dhe përfaqësues të tjerë në bazë të rastit që shqyrtohet. Të dy ekipet e krijuara në nivel lokal janë në proces trajnimi se si të përdorin programin për vlerësimin e rrezikut të cenueshmërisë "Kanali" ⁵⁴ Me mbështetjen e GCERF-it dhe donatorëve të tjerë, Maqedonia e Veriut, Bosnja dhe Hercegovina dhe Shqipëria po kërkojnë gjithashtu të aplikojnë programin "Channel" në punën e tyre, duke u bazuar në përvojën e Kosovës.

Hapa praktikë për përmirësim

Siç u bë e qartë në këtë dokument, menaxhimi i kundërvajtësve të dhunshëm ekstremistë dhe terroristë pas lirimit nga burgu është një proces kompleks dhe i ndjeshëm. Kërkon angazhimin e agjencive dhe palëve të ndryshme të interesit. Ky seksion i dokumentit ofron disa hapa praktikë që mund të përmirësojnë më tej progresin ekzistues të bërë nga vendet e Ballkanit Perëndimor në P/KEDH dhe SHRR:

- *Të përcaktohen dhe të zbatohen udhëzime të qarta për ndarjen e informacionit dhe koordinimin ndërmjet agjencive të sigurisë të përfshira në SHRR. Ky koordinim do ta lehtësojë menaxhimin më të mirë të rasteve dhe dizajnimin e ndërhyrjeve gjatë periudhës pas lirimit nga burgu. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet rregullimit të shkëmbimit të të dhënave dhe sistemeve të koordinimit në lidhje me KDHE-të nga Policia, Ministrinë e Sigurisë/Brendshme, autoritetet korrektuese dhe autoritetet e provës në vendet e Ballkanit Perëndimor.*
- *Të përgatiten dhe të hartohen hapa për përfshirjen e komunitetit në SHRR, duke përfshirë inkuadrimin e komuniteteve lokale, liderëve fetarë dhe organizatave të shoqërisë civile në procesin e rehabilitimit dhe riintegrimin gjatë periudhës pas lirimit*

⁵⁴ Intervistë me zyrtar të lartë të MPB-së në Kosovë. Maj 2023

- nga burgju. Ndërtimi i marrëdhënieve të forta me palët e interesuara lokale është thelbësor për një SHRR efektive të KDHE-ve dhe individëve të tjerë të riatdhesuar.
- Të përcaktohen kërkesat e trajnimit për profesionistët e përfshirë në menaxhimin pas lirimit nga burgju, të tillë si personeli i burgut, zyrtarët e zbatimit të ligjit, punonjësit në raste, punonjësit socialë, autoritetet arsimore, drejtuesit e komunitetit. Trajnimi adekuat do të rrisë cilësinë e shërbimeve të ofruara për KDHE-të, të cilat janë thelbësore për procesin e SHRR-së.
 - Të forcohet bashkëpunimi me organizatat me bazë në komunitet për të hartuar dhe zbatuar programe rehabilitimi dhe riintegrimi gjatë periudhës pas lirimit nga burgju. Partneriteti me OSHC-të lokale mund të ndihmojë në nisjen e fushatave të ndërgjegjësimit publik, duke potencuar pranimin dhe mbështetjen për KDHE-të që kanë marrë pjesë në programet e SHRR-së.
 - Të fillohen fushata ndërgjegjësimi publik që nxjerrin në pah rëndësinë e pranimit dhe mbështetjes për individët e reformuar. Të prezantohen historitë e suksesit të ish të burgosurve që janë riintegruar me sukses në komunitetet e tyre.

Mësimet kryesore të nxjerra dhe rekomandimet

SHRR-ja ka qenë një fenomen i ri për Ballkanin Perëndimor. Në fazën fillestare të këtij procesi, institucioneve u mungonin stafi profesional dhe burimet për të zbatuar masat e SHRR-së. Gjatë këtij procesi, Ballkani Perëndimor ka arritur të ndërtojë mekanizma institucionalë për të punuar me KDHE-të dhe të kthyerit. Janë zbatuar disa iniciativa të suksesshme të SHRR-së në burgje dhe në nivel të komunitetit. Është arritur një progres i dukshëm në procesin e parandalimit të radikalizimit në institucionet korrektuese. Disa fusha të cilat kanë nevojë për më shumë fokus nga institucionet politike për përmirësim janë përfshirja e komunitetit në procesin e SHRR-së në fazën pas lëshimit të KDHE-ve nga burgju dhe rritja e koordinimit institucional ndërmjet nivelit qendror dhe komunave në procesin e SHRR-së. Më poshtë janë dhënë disa rekomandime që mund të ndihmojnë në adresimin e çështjeve që lidhen me SHRR-në.

- Ballkani Perëndimor duhet të krijojë mekanizma të veçantë për SHRR të KDHE-ve dhe të kthyerve. Këto mekanizma duhet të krijohen në kuadër të Ministrive të Sigurisë/të Brendshme, Autoriteteve Korrektuese dhe të Provës dhe komunave lokale dhe OSHC-ve në komunitet. Këta mekanizma do të ndihmojnë vendet e Ballkani Perëndimor që të përgatisin ndërhyrje më të mira të SHRR-së për KDHE-të dhe të kthyerit. SHRR-ja duhet të decentralizohet në nivel lokal. Kjo mund të arrihet duke rritur kapacitetet profesionale të komunave dhe të organizatave të shoqërisë civile për SHRR. Përfshirja e aktorëve komunal mund të bëhet duke rritur kapacitetet profesionale të komunave dhe OSHC-ve.
- Autoritetet kryesore të vendeve të Ballkanit Perëndimor të përfshira në LT dhe SHRR duhet të standardizojnë Mjetet e Vlerësimit të Rrezikut dhe Kornizat e Vlerësimit të Cenueshmërisë kur punojnë me KDHE-të dhe të kthyerit. Përdorimi i standardeve, kornizave dhe procedurave të ngjashme për vlerësimin e rrezikut dhe evaluimin do të luajë një rol vendimtar në menaxhimin e rasteve të KDHE-ve dhe të të kthyerve të tjerë. Kjo qasje do të ndihmojë institucionet në monitorimin më të mirë të sjelljeve të KDHE-ve, duke dizajnuar ndërhyrje të SHRR-së duke u bazuar në të dhëna, dhe do të përmirësojë bashkëpunimin midis shumë agjencive për SHRR.
- Bazat e të dhënave që përmbajnë informacione të KDHE-ve të mbahen nga agjencitë e zbatimit të ligjit dhe institucionet shtetërore të përfshira në aktivitetet e P/KEDH dhe SHRR, duhet të jenë të aksesueshme për policinë, MPB-në, autoritetet korrektuese dhe provuese. Ky proces duhet të rregullohet në bazë të legjislationit vendor të çdo vendi.

Ndarja e të dhënave dhe shkëmbimi i të dhënave ndërmjet profesionistëve të përfshirë në SHRR është thelbësor për menaxhimin më të mirë të rasteve të KDHE-ve.

- Duhet të hulumtohet shkëmbimi i të dhënave të individëve të radikalizuar të liruar, mes partnerëve rajonalë. Sidomos ata të larguar nga burgu që nuk respektojnë asnjë program rehabilitimi. Madje edhe nëse shkalla e recidivizmit mund të jetë e ulët, ka pasur sulme terroriste në BE që përfshijnë individë të liruar pas vuajtjes së dënimit.
- Qeveritë e vendeve të Ballkanit Perëndimor, së bashku me donatorët ndërkombëtarë dhe komunat lokale, duhet bashkërisht të zhvillojnë plane me hapa dhe strategji të qarta për të siguruar qëndrueshmërinë e ekipeve multidisiplinare për parandalimin e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm në nivel lokal. Në të ardhmen, këta mekanizma lokalë nuk duhet të mbështeten vetëm në përkrahjen e donatorëve të huaj, por duhet të integrohen si pjesë e organit lokal komunal.
- Institucionet e vendeve të Ballkanit Perëndimor duhet të përdorin protokollet dhe standardet ekzistuese të punës dhe t'i përshtatin ato me nevojat e tyre për monitorimin e procesit të SHRR të KDHE-ve pas lirimit të tyre nga burgu. Institucionet qendrore, në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet lokale dhe komunitetet, duhet të identifikojnë mangësitë dhe sfidat kryesore të LHTF-ve dhe të kthyerve të tjerë në procesin e SHRR-së. Duhet të zhvillohet një plan gjithëpërfshirës integrimi, duke përfshirë ndërhyrje konkrete për të lehtësuar riintegrimin e KDHE-ve dhe të kthyerve në komunitet.
- Programet P/KEDH dhe R&R të vendeve të Ballkanit Perëndimor fokusohen në adresimin dhe parandalimin e ekstremizmit islamist, ndërkohë që u kushtojnë më pak vëmendje formave të tjera të ekstremizmit. Është e rëndësishme që vendet e Ballkanit Perëndimor të synojnë forma të tjera të ekstremizmit, siç janë ideologjitë e ekstremit të djathtë dhe etno-nacionalizmi.
- Vendet e Ballkanit Perëndimor, veçanërisht Serbia, Boshnja dhe Mali i Zi, duhet të jenë të vetëdijshme për rreziqet dhe kërcënimet që mund të lindin nga kthimi i luftëtarëve nga Ukraina. Autoritetet shtetërore në ato vende duhet të zhvillojnë programe gjithëpërfshirëse të SHRR-së për LHT-të nga Ukraina gjatë burgosjes së tyre. Këto plane të SHRR-së duhet t'u përshtaten individëve dhe mjediseve të tyre dhe të fokusohen në adresimin e nevojave dhe shqetësimeve kryesore të KDHE-ve dhe luftëtarëve të huaj të kthyer.

Për autorin:

Skender Perteshi ka diplomuar për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci në Kolegjin Universitar "Universum". Skenderi është autor dhe bashkautor i shumë raporteve kërkimore në lidhje me temat e sigurisë si: terrorizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm. Skenderi ka punuar gjithashtu si bashkëpunëtor i ri/i lartë dhe konsulent për organizata ndërkombëtare dhe lokale në tema të lidhura me sigurinë si: Fondacioni "Finn Church Aid"- Helsinki, Instituti RUSI, Organizata Ndërkombëtare e Migracionit (IOM), OSBE-ja dhe organizata të tjera. Interesat kërkimore të Skenderit përfshijnë: Radikalizimin, Ekstremizmin e Dhunshëm dhe Terrorizmin, Mbrojtjen e Infrastrukturës Kritike, Mbrojtjen Kibernetike, Reformat e Sektorit të Sigurisë, Rezistencën e Komunitetit, Diasporën dhe Sigurinë, Lëvizjen Sociale dhe Identitetin.

Bibliografia

Associated Press NEWS “23 Albanians, others from Kosovo are repatriated from Syria” May, 28, 2022 < <https://apnews.com/article/islamic-state-group-middle-east-syria-albania-iraq-57d8b19ef5cafef5a63e8180d0d1346f>

Asya Metodieva « Bringing them back » 2021chrome extension://efaidnbmnnnibpcajpcgclefindmkaj/https://atlanticinitiative.org/wp-content/uploads/2021/05/Policy-Paper-NO.-1-ENG.pdf

Balkan Insight analyses “Montenegro urged to prevent volunteers fighters going to Ukraine” March 1, 2022. < <https://balkaninsight.com/2022/03/01/montenegro-urged-to-prevent-volunteer-fighters-going-to-ukraine/>>

Chrome extension://efaidnbmnnnibpcajpcgclefindmkaj/https://qkss.org/images/uploads/files/Kosovo-D3.2-country-report_208701_.pdf

CSS report in Sarajevo “Disengagement, Rehabilitation and Reintegration of Foreign Terrorist Fighters” Drive Project funded the European Union’s Internal Security Fund – Police. March 2022 chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcgclefindmkaj/https://drive-ontherightpath.eu/wp-content/uploads/2022/05/drive-report-bosnia-23-05-2022.pdf 12. 1Korajlić Nedžad, Kržalić Armin, Kržalić Aida, Plevljak Benjamin, Dulaš Imer (2020). TRAVELLERS TO SYRIA: A Criminological and Security Analysis with Special Focus on Returnees from Syrian Battlefronts. Published by Faculty of Criminalistics, Criminology and Security Studies, University of Sarajevo. <https://hedayahcenter.org/resources/travelers-to-syria-a-criminological-and-securityanalysis-with-special-focus-on-returnees-from-syrian-battlefronts/>

Disengagement, Rehabilitation and Reintegration of Foreign Terrorist Fighters” March 2022 <chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcgclefindmkaj/https://drive-ontherightpath.eu/wp-content/uploads/2022/05/drive-report-nort-macedonia-23-05-22.pdf>

Disengagement, Rehabilitation and Reintegration of Foreign Terrorist Fighters” March 2022 chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcgclefindmkaj/https://drive-ontherightpath.eu/wp-content/uploads/2022/05/drive-report-bosnia-23-05-2022.pdf

DW news agency “Serbian and Croatian volunteers are fighting in Ukraine” 1-31-2023, < <https://www.dw.com/en/serbian-croatian-volunteers-fight-on-ukraines-front-line/a-64563304>>

extension://efaidnbmnnnibpcajpcgclefindmkaj/https://qkss.org/images/uploads/files/Extremis em-Barometer-ENG_672182.pdf>

Kosovo Security Barometer Report 2022. <chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcgclefindmkaj/https://qkss.org/images/uploads/files/Extremis em-Barometer-ENG_672182.pdf>

Maja Halilovic Pastuovic, Johanna-Maria Hülzer, Gillian Wylie 2023. Violent Extremism in the Western Balkans and MENA Region: Key findings and implications for research. Theoretical Synthesis Paper. PAVE Project Publications. https://www.pave-project.eu/user/pages/07.publications/PAVE_Theoretical_Synthesis_Paper.pdf

Papp, Z.S. and Örell, R. (2021). Returning to Extremism: An Overview on Terrorist Reoffending and Current Challenges. RAN, European Commission.

PAVE 2021. Policy Guidelines and Recommendations for Multi-Stakeholder Collaboration for Community Resilience Against Violent Extremism. PAVE Project

Publications. https://www.pave-project.eu/user/pages/07.publications/ENGLISH_PAVE_Policy_Guidelines.pdf

PAVE 2022. Policy Brief for Kosovo. PAVE Project Publications. https://www.pave-project.eu/user/pages/07.publications/PAVE_Policybrief_Kosovo_eng.pdf

Perteshi Skender “Beyond the triggers: New threats of Violent Extremism in Kosovo” 2018 .
<chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcgiclfndmkaj/https://qkss.org/images/uploads/files/violent-extremism-eng_611603.pdf>

Perteshi Skender and Orana Ardit “Disengagement, Rehabilitation and Reintegration of Foreign Terrorist Fighters” Drive Project funded the European Union’s Internal Security Fund – Police. March 2022 < chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcgiclfndmkaj/https://qkss.org/images/uploads/files/Kosovo*_report31_03_22.pdf>

Radio Free Europe “Serb who joined Russian-Backed forces in Ukraine has jailed sentence overturned” January 27, 2023. < <https://www.rferl.org/a/serbia-sentence-ukraine-separatists-overturned/32243089.html>>

Ramadan Ilazi, Ardit Orana, Teuta Avdimetaj, Bledar Feta, Ana Krstinovska, Yorgos Christidis and Ioannis Armakolas 2022. Online and offline (de)radicalisation in the Balkans. Working paper 5. PAVE Project Publications. chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcgiclfndmkaj/https://www.pave-project.eu/publications/PAVE_870769_D5.1_publication_layout.pdf

Ramadan Ilazi, Ardit Orana, Teuta Avdimetaj, Bledar Feta, Ana Krstinovska, Yorgos Christidis and Ioannis Armakolas 2022. Online and offline (de)radicalisation in the Balkans. Working paper 5. PAVE Project Publications. https://www.pave-project.eu/user/pages/07.publications/PAVE_870769_D5.1_publication_layout.pdf

RCC analyses “Analysis: Balkan States Find Prosecuting Terrorism a Challenge” August 2020 < <https://www.rcc.int/swp/news/290/analysis-balkan-states-find-prosecuting-terrorism-a-challenge>>

Sead Turčalo, Jelena Brkić-Šmigoc, Mirza Smajić, Veldin Kadić, Muamer Hirkić, Maja Halilovic Pastuovic, Goran Tepšić, Nemanja Džuverović, Gillian Wylie 2022. Cumulative Extremisms in the Balkans. Working Paper 1. PAVE Project Publications. https://www.pave-project.eu/user/pages/07.publications/PAVE_870769_D3.1_publication_layout.pdf

Teuta Avdimetaj “Stakeholders of (De) Radicalisation in Kosovo” D.RAD 3.1 report conducted under the Horizon 2020 project “Deradicalisation in Europe and beyond- Detect, Resolve and Re-Integrate” 2021

Training Manual for Frontrunners “Mapping of R&R services for persons returning from conflict areas” IDM 2021. < [file:///Users/skenderperteshi/Downloads/Hartezimi-i-programeve-RR%20\(2\).pdf](file:///Users/skenderperteshi/Downloads/Hartezimi-i-programeve-RR%20(2).pdf)>

Vlado Hazinovic (2018) Regional Report “Understanding the Violent Extremism in Western Balkans” British Council. chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcgiclfndmkaj/https://www.gcerf.org/wp-content/uploads/2015/12/GCERF-RNA-Western-Balkans-final.pdf

GJETJA E INFORMACIONIT RRETH BE-së

Online

Të dhëna lidhur me Bashkimin Evropian në të gjitha gjuhët zyrtare të BE-së ka në ueb-faqen Europa në: https://europa.eu/european-union/index_en

Publikimet e BE-së

Mund të shkarkoni ose të porositni publikime të BE-së falas dhe me pagesë nga: <https://op.europa.eu/en/publications>. Shumë kopje të publikimeve falas mund të gjenden duke kontaktuar Europe Direct ose qendrën tuaj lokale të informimit (shih https://europa.eu/european-union/contact_en).

Ligjet e BE-së dhe dokumentet përkatëse

Për qasje në të dhëna ligjore nga BE-ja, duke përfshirë të gjitha ligjet e BE-së që nga viti 1952 në të gjitha versionet në gjuhët zyrtare, shkoni në EUR-Lex në: <http://eur-lex.europa.eu>

Të dhëna të hapura nga BE-ja

Portali i të dhënave të hapura të BE-së (<http://data.europa.eu/euodp/en>) siguron qasje në grupet e të dhënave nga BE-ja. Të dhënat mund të shkarkohen dhe ripërdoren falas, për qëllime komerciale dhe jokomerciale.

Radicalisation Awareness Network



Publications Office
of the European Union